



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:179354
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597064

C.nr.2583/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit E.S. nga fshati V. – Komuna e Istogut, të cilin e përfaqëson Fatmir Ademaj, avokat në Pejë kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”- Prishtinë, Rr. “2 Korriku” nr.4, me bazë juridike kompensim dëmi sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 2.500 euro, jashtë seance me datën 19.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit E.S. nga fshati V. – Komuna e Istogut, e parashtruar me datë 23.08.2023, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”- Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 2.500 euro.

II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi E.S. nga fshati V. – Komuna e Istogut, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”- Prishtinë, me bazë juridike Kompensim dëmi sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 2.500 euro.

Gjykata, me datën 02.04.2024, ka pranuar parashtrësën e paditësit, me anë të së cilës parashtrësë, i njëjti ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës me arsyetim se paditësi e ka realizuar interesin juridik në procedurë jashtëgjyqësore, me të paditurën Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”- Prishtinë.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*,

andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2583/23, me datë 19.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.